



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 72 Datë 01.08.2018

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin
Organi auditues	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Numri i procedurave të audituara	7, si dhe procedura prokurimi të zhvilluara në mënyrë të përqendruar dhe shtesa kontratash
Lloji i procedurës/ave të audituara	“Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, “Kërkesë për propozim”.
Konstatimet kryesore	<p>1. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, pika 1, të LPP, lidhur me mungesën e kërkesës në dokumentat e tenderit të listpagesave për punonjësit e kërkuar, për shërbimin e ruajtjes me roje private.</p> <p>2. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 53, pika 3, të LPP, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të shpallur fitues në dy procedura prokurimi, të zhvilluara në vitin 2016.</p> <p>3. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, pikat 2 dhe 3, të VKM Nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me përgatitjen dhe dërgimin për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, brenda afatit të përcaktuar, të njoftimit të kontratës së nënshkruar.</p> <p>4. AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 9 dhe 29 të VKM Nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me mungesën e ndarjes në lote të barnave dhe materialeve të mjekimit.</p>
Masat e marra	Në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë

	<p>20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj titullarit të AK (për periudhën e audituar), ndaj 3 anëtarëve të njësisë së prokurimit, si dhe ndaj 4 anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurat e audituara.</p>
--	--